



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë  
Nr. Dok. 202002212/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** Rekomandime për inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Librazhd.

**Drejtuar:** Kryekomisar Bedri HASANAJ  
Shef i Komisariatit të Policisë Librazhd

**LIBRAZH**

**Për dajeni:** Drejtues i parë Arjan MUÇA  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan

**ELBASAN**

*Të nderuar zotërinj,*

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, ç'njerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar<sup>1</sup>, bazuar në nenin 19/1 të Ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Komisaratin e Policisë Librazhd.

Inspektimi u krye në datën 12.02.2020, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues morën pjesë z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita, me detyrë Nd/Komisioner pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306, datë 31.03.2016, për miratimin e procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici", si dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimit të mëparshëm.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, si më poshtë vijon:

<sup>1</sup> Neni 81 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

## **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit u takua me shefin e Komisarariatit të Policisë Librazhd, z.Bedri Hasanaj, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Pasi u njoh me qëllimin e inspektimit, shefi i Komisarariatit informoi grupin e inspektimit në lidhje me kushtet në të cilat ndodhet ambienti i shoqërimit, angazhimin e punonjësve të policisë të këtij komisaritati për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të personave të privuar nga liria në këto ambiente, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Grupi i inspektimit, shoqëruar nga shefi i komisarariatit, vijoi inspektimin në ambientet e shoqërimit të komisarariatit, vizitoi zyrat e punonjësve të policisë, si dhe u njoh me dokumentacionin përkatës ku pasqyroheshin veprimet e kryera me personat e shoqëruar dhe të arrestuar apo ndaluar.

Drejtuesi dhe punonjësit në Komisariatin e Policisë Librazhd, me të cilët kontaktoi grupi i inspektimit, u treguan bashkëpunues gjatë komunikimit dhe inspektimit që zhvilloi në këto ambiente.

Në inspektimin e vitit të kaluar, Mekanizmi Kombëtar konstatoi se ambienti i shoqërimit ishte duke u rindërtuar dhe personat e shoqëruar apo të ndaluar, pas përfundimit të procedurave nga punonjësit e policisë, dërgoheshin menjëherë në ambientet e Komisarariatit të Policisë Elbasan.

Ndërkohë, nga inspektimi për vitin 2020 rezultoi se, **kishte përfunduar ndërtimi i godinës së re e përbërë nga dy ambiente, nga zyra për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe nga mjedisi që shërben për mbajtjen dhe qëndrimin e personave të shoqëruar, me kushte funksionale të përshtatshme.**

Ky investim ishte financuar nga programi Qeverisë Suedeze për Policimin në Komunitet (SCPA), mbi bazën e projektit të miratuar nga strukturat përgjegjëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në përfundim të inspektimit u konstatua se, vazhdonin të ishin të pranishme disa problematika, si më poshtë vijon:

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Librazhd, ambientet e ri i shoqërimit ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në ligjin nr.108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe procedurën standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në polici*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.306 datë 31.03.2016.

Mjedisi i shoqërimit përbëhet nga dy dhoma shoqërimi të ndara më vete, një dhomë për qëndrimin e personave të rritur dhe një dhomë për mbajtjen dhe qëndrimin e të shoqëruarve femra dhe të mitur.

Dhomat e shoqërimit ishin sipas standardeve me sipërfaqe dhe hapsirë të bollshme për qëndrimin ulur të personave, me kushte të përshtatshme dhe të kompletuara me të gjitha

orenditë e pajisjet e nevojshme si tavolina pune e karrige të reja, për trajtimin dinjitoz të shtetasve të shoqëruar.

Dritaret e dhomave të shoqërimit ishin me përmasa të tilla që lejonin ajrimin e plotë dhe hyrjen e dritës natyrale. Dhomat kishin ndriçim që furnizohej nga rrjeti elektrik. Në pjesën e jashtme, dritaret e dhomave të shoqërimit **nuk** ishin të siguruara me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise<sup>2</sup>. Sipas informacionit të shefit të komisariatit, vendosja e skarave apo mjeteve të tjera mbrojtëse në pjesën e jashtme të dritareve, nuk ishin në projektin e zbatimit nga investitori, ndaj nuk ishte bërë e mundur vendosja e tyre. Por, në vlerësimin tonë vendosja e skarave apo mjeteve mbrojtëse, janë një element i domosdoshëm për sigurinë fizike dhe sigurinë e jetës të personave të shoqëruar në këto mjedise.

Në ambientin e shoqërimit ndodhej dhe një dhomë më vete për marrjen në pyetje apo intervistimin e personave të shoqëruar, nga punonjësit e policisë. Dhoma e intervistimit ishte e pajisur me orëdi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si, tavolina e karrige për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, por ato **nuk** ishin të fiksuara në dysheme në mënyrë të palëvizshme, sikurse përcaktohen në procedurat standarde<sup>3</sup>.

Mjedisi dhe dhomat e shoqërimit ishin të mirëmbajtura, të lyera dhe të pastra nga ana higjieno sanitare. Ngjitur me dhomat e shoqërimit ndodheshin dy tualete, të ndara më vete për femra dhe meshkuj, me ujë të rrjedhshëm dhe të pajisura me të gjitha mjetet e domosdoshme për këtë qëllim.

Në mjedisin e shoqërimit, grupi i inspektimit, nuk gjeti sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Në korridorin dhe brenda në dhomat e shoqërimit, ishin afishuar posterat me të drejtat e personave të shoqëruar në mjediset e policisë, si dhe personave të ndaluar/arrestuar, të cilat ishin të aksesueshme nga këta persona.

Godina ku ndodhej mjedisi i shoqërimit, ambientet e brendshme dhe në pjesën e jashtme të saj, ishte survejuar nga sistemi i kamerave përgjatë 24 orëve.

Në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte asnjë person të shoqëruar në mjediset e komisariatit, për rrjedhojë grupi i inspektimit nuk realizoi intervista lidhur me trajtimin që iu bëhet personave nga ana e punonjësve të policisë nga momenti i shoqërimit, gjatë kohës së qëndrimit në dhomat e shoqërimit, marrjes në pyetje apo intervistimin e tyre.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Në Komisarlatin e Policisë Librazhd nuk kishte të miratuar ambiente të sigurisë. Personat e arrestuar/ndaluar, pasi përfundonin veprimet proceduriale nga punonjësit e policisë, dërgoheshin në dhomat e sigurisë të Komisarlatit të Policisë Elbasan.

### **Regjistri i personave të shoqëruar dhe trajtimi i të shoqëruarve.**

---

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3/g Procedurat standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici".

<sup>3</sup> Kreu VI, pika 3/d Procedurat standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në polici".

Gjatë inspektimit u konstatua se në Komisarariat e Policisë Librazhd, “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i ri sipas tipit “Model nr.1”, konform procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr.306 datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ky regjistër ishte i sekretuar.

Personat e shoqëruar në mjediset e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se, koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri në 10 orë në raste të veçanta. Rubrikat e regjistrimit ishin plotësuar në mënyrë korrekte, me përgjegjësi dhe saktësi nga punonjësit e policisë në zyrën e informacionit<sup>4</sup>.

Në këtë Komisarariat kishte regjistër për personat e arrestuar/ndaluar, ku evidentoheshin të gjitha rastet e ndalimeve dhe arrestimeve të kryera nga punonjësit e këtij organi, i cili ishte i sekretuar. Nga kqyrja e këtij regjistri rezultoi se në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën në momentin e shoqërimit të tyre në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën e inspektimit, nuk ishte evidentuar dhe pasqyruar asnjë ankesë apo kërkesë nga këta persona.

### **Ambientet e intervistimit**

Ambjenti i ri i shoqërimit, kishte mjedise të përshtatshme më vete për marrjen në pyetje apo intervistimin e personave të shoqëruar nga specialistët dhe ndihmës specialistët e policisë të këtij komisarati. Ky ambient, ishte i monitoruar me kamera për vëzhgimin gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e policisë.

Krijimi i zyrave të veçanta ku merren në pyetje shtetasit gjatë kryerjes së veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore dhe instalimin e sistemit të monitorimit me kamera në këto zyra, është rekomandim i Avokati i Popullit referuar standardeve ndërkombëtare<sup>5</sup>, të cilat e konsiderojnë procesin e monitorimit filmik si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit.

Nga monitorimi i disa prej zyrave të punonjësve të policisë, nuk u gjetën sende, prania e të cilave të ekspozonte dhunë tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Por, godina kryesore e këtij komisarati ishte e vjetër dhe amortizuar, dhe në ambientet e brendshme kishte lagështirë.

---

<sup>4</sup> *Kreu VII, Procedurat standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”.*

<sup>5</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë të bërë nga i ndaluar gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” *CPT’ reports; Armenia: Visit 2010[par.18]*

## **Ndihma juridike dhe psikologjike**

Nga pyetja e punonjësve të policisë, rezultoi se në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit në moshë madhore, të cilët nuk kishin mundësi financiare për të marrë avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, iu sigurohej mbrojtja me avokat të caktuar kryesisht.

Ndërsa, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, ata shoqëroheshin menjëherë për në ambientet e sigurisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, për kryerjen e veprimeve procedurale nga oficerët e policisë gjyqësore të seksionit për të miturit dhe në praninë e detyrueshme të kujdestarit ligjor, avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë Elbasan, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale. Ndërsa psikologu, për kohën e qëndrimit në ambientet e këtij komisariati sigurohej në bashkëpunim me shkollën e mesme të qytetit Librazhd dhe më tej, asistohet nga psikologu që është në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridorin e godinës ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar në organin e policisë.

Ndërkohë u konstatua se në këtë Komisarariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit Nr. 108/2014 “*Për Policinë e Shtetit*”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Përsa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”, me qëllim zgjidhjen e problemeve të konstatuara gjatë këtij inspektimi,

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme në Komisariatin e Policisë Librazhd, për sigurimin fizik të dritareve të dhomave të shoqërimit në pjesën e jashtme të tyre me mjete mbrojtëse (skara), me qëllim parandalimin e largimit apo arratisjes së personave të shoqëruar nga këto mjedise.
2. Marrjen e masave të nevojshme në dhomat e shoqërimit, që orenditë e nevojshme si tavolinat e punës dhe karriget që shërbejnë për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të jenë të fiksuara në dysheme dhe të pa lëvizshme, sikurse përcaktohen në procedurat standarde.
3. Marrjen e masave të menjëhershme për njohjen e stafëve të punonjësve të policisë me rekomandimet e CPT (European Committee for the Prevention of Torture/Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës) të evidentuar në raportin përfundimtarë për

Shqipërinë të botuar në muajin shtator 2019<sup>6</sup>, si dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.*

**KOMISIONER**

**Ermonela XHAFA**

---

<sup>6</sup> Raporti CPT për Shqipërinë botuar më 17 shtator 2019.